



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 143

Tiranë – E Enjte, 18 Shtator 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret nr. 8712 datë 12.9.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 6589
Vendim i KM nr. 582, datë 10.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 846, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të disa objekteve dhe truallit funksional, pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-regjimenti i kimisë”, me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar” 6589
Vendim i KM nr. 583, datë 10.9.2014	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Arteve..... 6589
Vendim i KM nr. 584, datë 10.9.2014	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy of Tirana) 6591
Vendim i KM nr. 585, datë 10.9.2014	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar, “Albanian College Durrës”..... 6592
Vendim i KM nr. 587, datë 10.9.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass, Fier - Levan”..... 6593
Vendim i KM nr. 588, datë 10.9.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 12, datë 6.1.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafëthanë - Lin - Pogradec, loti I”..... 6595

Vendim i KM nr. 590, datë 10.9.2014	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të objektit “Tsh-Kombinati i Tekstileve”, Berat, me numër pasurie 19/59, në zonën kadastrale 8501, dhe sipërfaqe 8 117 m ² , dhe për një ndryshim në vendimin nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit”.....	6596
Vendim i KM nr. 591, datë 10.9.2014	Për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve “Të bësh biznes”	6597
Vendim i KM nr. 592, datë 10.9.2014	Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse	6601
Vendim i KM nr. 593, datë 10.9.2014	Për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-Up”	6603
Vendim i KM nr. 595, datë 10.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 938, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të klubit sportiv “Dinamo” nga Ministria e Brendshme te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar”	6604
Vendim i KM nr. 596, datë 10.9.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione, për festimet e 70-vjetorit të Çlirimit të Vendit	6604
Vendim i KM nr. 597, datë 10.9.2014	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2014, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, për mbulimin e shpenzimeve për shtesë punimesh në zbatim të projekteve “Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve” dhe “Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve”	6605
Vendim i KM nr. 598, datë 10.9.2014	Për shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për përballimin e shpenzimeve, në kuadër të organizimit të punëve në vijim të ardhjes së Papa Françeskut në Shqipëri	6606
Vendim i KM nr. 599, datë 10.9.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1139, datë 24.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore”, të ndryshuar	6606
Vendim i KM nr. 600, datë 10.9.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 848, datë 6.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive “Telemenialb”, sh.a., “F.K. Generators Equipment”, Ltd, e “Melta Inter Industries”, l.t.d., për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Curraj”	6607
Vendim i KM nr. 602, datë 10.9.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet”, të ndryshuar	6610

**DEKRET****Nr. 8712, datë 12.9.2014****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Visar Agim Bekaj
2. Egzonë Rifat Zeka
3. Viona Veton Rexhepi
4. Diellza Sami Muza
5. Valbonë Ylber Lipa
6. Endrina Idiz Elezaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM**Nr. 582, datë 10.9.2014**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 846, DATË 27.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 84, ME EMËRTIM “ISH-REGJIMENTI I KIMISË”, ME VENDNDODHJE NË SHTISH-TUFINË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË

NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 846, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... për t’i përdorur për ngritjen e një vendqëndrimi për strehimin e familjeve të komunitetit rom ...” zëvendësohen me “për t’i përdorur për ngritjen e funksionimit të Qendrës Kombëtare Transitore të Emergjencës ...”.

2. Ngarkohen ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 583, datë 10.9.2014**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI UNIVERSITETIT TË
ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 82, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Arteve.

Lista me 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1 (një).



2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Arsimit dhe Sportit, Universiteti i Arteve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE (Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni qendror: Universiteti i Arteve											
Fusha e përdorimit të pronës: arsim universitar											
A			B				C				
Nr. Rend	Zona kadas. indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Emërtesa e pronës Vëndndodhja/ shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vëndndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1	8270 Tr-S-11.12	4/104	Universiteti i Arteve, Tiranë			13 936	Arsim universitar	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesa të shkallëzuara Sipërfaqe totale ndërtimi 13 870 m ²	
			Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”; Sheshi “Nënë Tereza”	Truall funksional rreth ndërtesave	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Sheshi “Nënë Tereza”	5 488	Truall	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve		
				Ndërtesa A Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Salla e Koncerteve	“	1 630	Administratë, ambiente mësimi, sallë koncertesh	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë e shkallëzuar në 2,3 dhe 5 kate	
				Ndërtesa B Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik	“	636	Aktivitet arsimor	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë në 2 dhe 3 kate	
				Ndërtesa C Fakulteti i Artit Skenik, Biblioteka	“	502	Aktivitet arsimor	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë 2 kate	
1				Ndërtesa D Fakulteti i Artit Skenik	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Sheshi “Nënë Tereza”	479	Administratë dhe aktivitet arsimor	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë 2 kate	
				Ndërtesa E Fakulteti i Arteve të Bukura	“	1 178	Administratë dhe aktivitet arsimor	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë 2 dhe 3 kate	
				Ndërtesa F Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik	“	575	Aktivitet arsimor	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë 3 kate	
				Objekti G Teatri Veror	“	490	Aktivitet kulturor	Universiteti i Arteve	Universiteti i Arteve	Ndërtesë 1 kat, pa mbulesë, Ndërtim dhuratë nga një donator	

**VENDIM****Nr. 584, datë 10.9.2014****PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E
INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR “AKADEMIA
BOTËRORE E TIRANËS” (WORLD
ACADEMY OF TIRANA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” (World Academy of Tirana) nga subjekti, shoqëria “Montessori Albania”, sh.p.k.

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” do ta ushtrojë veprimtarinë arsimore në adresën: rruga “Bilal Golemi”, nr. 17, Tiranë.

3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës”, mësimi do të zhvillohet në gjuhë të huaj anglisht. Në lëndët: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, histori e kombit shqiptar dhe gjeografi e Shqipërisë, mësimi do të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.

4. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” do të ofrojë arsimim parauniversitar në nivelin e arsimit të mesëm të lartë - gjimnaz dhe forma e arsimit do të jetë arsimim me kohë të plotë.

5. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës”, me fillimin dhe gjatë veprimtarisë së tij, të raportojë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara, për:

a) numrin e nxënësve, që do të fillojnë e do të mbarojnë vitin shkollor, dhe listën e mësuesve sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) planin mësimor dhe programet e lëndëve që do të zhvillojë institucioni;

c) strukturën e vitit shkollor që do të ketë institucioni, e cila duhet të jetë e barasvlefshme me atë të shkollave publike të të njëjtut nivel, së bashku me kalendarin e veprimtarive vjetore të institucionit;

c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

d) lëndët mësimore të detyrueshme njëloj me ato të shkollave publike;

dh) lëndët mësimore të ndryshme nga ato të planeve mësimore të institucioneve ekuivalente publike;

e) lëndët me zgjedhje dhe ato fakultative.

6. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të ketë regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore, regjistra të përkohshëm, rregullore të brendshme për funksionimin e institucionit, si dhe çdo dokumentacion që ky institucion e përdor si dokument bazë.

7. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si dhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik, që kërkon të kryejë sipas rastit.

8. Ndryshimet në vendndodhje dhe në infrastrukturën e godinës, që mund të pësojë institucioni arsimor privat, shqyrtohen dhe miratohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pas miratimit nga njësia arsimore vendore, 3 (tre) muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

9. Institucioni arsimor privat parauniversitar duhet të ketë në ruajtje të gjitha të dhënat sipas standardeve të miratuara nga Instituti i Statistikave, si dhe të dhëna të tjera më të hollësishme, që mund të kërkojnë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për veprimtarinë e tyre arsimore.

10. Dokumentacioni i institucionit arsimor privat parauniversitar dhe të dhënat e tjera, përcaktuar në këtë vendim, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihen në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

11. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” duhet të funksionojë në përputhje me legjislacionin shqiptar, që rregullon funksionimin e institucioneve arsimore private dhe të institucioneve arsimore plotësuese private, që zhvillojnë mësimin në gjuhë të huaj, në përputhje me konventat, traktatet dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, duke respektuar realitetin shqiptar, arritjet dhe traditat e shkollës kombëtare shqiptare.

12. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e



informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo do të kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësia arsimore vendore, nën juridiksionin e së cilës është ky institucion arsimor, dhe institucioni arsimor privat parauniversitar “Akademia Botërore e Tiranës” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 585, datë 10.9.2014

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E
INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT
PARAUNIVERSITAR, “ALBANIAN
COLLEGE DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës”.

2. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës”, do të ushtrojë veprimtarinë arsimore në adresën: Rruga “Anastas Durrsaku”, nr. 1, Durrës.

3. Në institucionin arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës”, mësimi do të zhvillohet në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze). Në lëndët: gjuha shqipe, letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë mësimi do të zhvillohet, detyrimisht, në gjuhën shqipe.

4. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës” do të ofrojë arsimim parauniversitar në nivelet:

- arsim parashkollor;
- arsim bazë;
- arsim i mesëm i lartë (gjimnaz).

5. Forma e arsimit në institucionin arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës” do të jetë arsimim me kohë të plotë.

6. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës” me fillimin dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, të raportojë në njësinë arsimore vendore, brenda afateve të përcaktuara, për:

a) numrin e fëmijëve të kopshtit, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve që do të fillojnë dhe do të mbarojnë vitin shkollor, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe statistikave të miratuara nga INSTAT-i;

b) planin mësimor, programet e lëndëve dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;

c) aktin e regjistrimit në organin tatimor;

ç) listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor.

7. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës” duhet të miratojë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit çdo ndryshim në planin mësimor, programet e lëndëve apo tekstet që do të përdorë, si edhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë, sipas rastit.

8. Ndryshimet që mund të pësojë institucioni arsimor privat parauniversitar i licencuar, në vendndodhjen apo në infrastrukturën e godinës, shqyrtohen dhe miratohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, pas miratimit të njësive arsimore vendore, 3 muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

9. Institucioni arsimor privat parauniversitar “Albanian College Durrës” duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar);

c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

ç) kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

d) kontratat me prindërit për shërbimet arsimore, apo shërbime të tjera jashtëshkollore, që ofron;



dh) kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë, apo me kohë të pjesshme).

10. Dokumentacioni i paraqitur në pikën 6, në rast monitorimi dhe inspektimi, u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

11. Institucioni arsimor privat parauniversitar, “Albanian College Durrës”, të funksionojë në përputhje me legjislacionin shqiptar, me konventat, traktatet dhe marrëveshjet e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, duke respektuar realitetin shqiptar, arritjet dhe traditat e shkollës kombëtare shqiptare.

12. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 587, datë 10.9.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS, FIER -
LEVAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken

nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-pass, Fier-Levan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për: tokë arë dhe truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 90 346 779 (nëntëdhjetë milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 90 346 779 (nëntëdhjetë milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.



11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “BY-PASS FIER”

Qarku: Fier

Komunat: Mbrostar, Ura, Qendër, Dërmenas, Levan

Nr.	PRONARI			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m ²)	Sipërfaqe që shpronësohet (m ²)	Çmimi njësi (leke/m ²)	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Besnik	Bashkim	Malasi	2636	101/37	Arë	17000	1384.4	437	604,983	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Aleks	Qerim	Adushaj	2636	101/29	Arë	5000	1047.8	437	457,889	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Qamil	Shaqir	Veliu	2636	101/28	Arë	6816	1198.2	437	523,613	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Bekdash	Pasho	Veliu	2636	100/2	Arë	3765	1227.7	437	536,505	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Indrit	Teki	Çela	2636	100/4	Arë	7277	2373.6	437	1,037,263	Barre hipotekore
6	Indrit	Teki	Çela	2636	100/19	Arë	3000	938.2	437	409,993	Barre hipotekore
7	Xhevair	Shefqet	Veliu	2636	100/20	Arë	8949	806.2	437	352,309	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Tomorr	Misir	Veliu	2636	100/7	Arë	4644	1350.9	437	590,343	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Iljaz	Isa	Fisheku	2636	124/4	Arë	373	62.2	437	27,181	Barre hipotekore
10	Shpetim	Faik	Gremi	2636	124/8	Truall	500	121.6	769	93510.4	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Gazmend	Fasli	Serjanaj	2636	124/12	Truall	500	73	769	56137	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Vito	Azbi	Serjanaj	2636	124/14	Truall	300	175	769	134575	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Luan	Ahmet	Gjoleka	2636	128/4	Ullishte	1000	1000.0	437	437,000	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Veli	Hysni	Kaja	2944	130/7	Arë	1987	1342.5	274	367,845	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Agim	Hysni	Kaja	2944	130/8	Arë	2000	1382.8	274	378,887	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Aleks		Kaja	2944	130/11	Arë	1732	976.9	274	267,671	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Ismet	Gani	Çruga	2944	129/41	Arë	1200	476.1	274	130,451	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Xhevdet	Haris	Metë	2944	129/65	Arë	1500	206.2	274	56,499	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Qemal	Sefer	Metaj	2944	129/86	Arë	3000	1012.8	274	277,507	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Isuf	Isa	Metaj(BP)	2944	129/68	Arë	2100	448.8	274	122,971	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Maksim		Marku	1453	173/26	Arë	1008	584.5	501	292,835	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Zini	File	Xhafa	1453	21/4	Arë	6400	2623.2	501	1,314,223	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Kadri	Ramadan	Dauti	3980	19/6	Arë	10043	7229.3	684	4,944,841	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Andon	Jorgji	Cuko(BP.)	3980	16/27	Arë	2740	805.2	684	550,757	Konfirmuar nga ZVRPP
25	Kozma	Jorgji	Cuko	3980	16/25	Arë	11000	3575.9	684	2,445,916	Konfirmuar nga ZVRPP
26	Florand	Peço	Vasiu	3980	16/21	Arë	1800	772.2	684	528,185	Barre Hipotekore
27	Dilaver	Elëz	Qelia	3980	5/50	Arë	4000	19	684	12996	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Novruz	Demir	Merko	3980	5/54	Arë	1800	1800.0	684	1,231,200	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Qazim	Ramadan	Merko	3980	4/4	Arë	9310	5952.0	684	4,071,168	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Vangjel	Fani	Byzyka	3980	3/43	Arë	5400	2526.8	684	1,728,331	Konfirmuar nga ZVRPP
31	Themi	Vangjel	Toska	1091	111/6	Arë	7792	3272.6	742	2,428,269	Konfirmuar nga ZVRPP
32	Muharrem	Rushit	Mahmuti	1414	1/81	Arë	1500	958.6	587	562,698	Konfirmuar nga ZVRPP
33	Zano	Lik	Kanaj	1414	1/55	Arë	2290	267.8	587	157,183	Konfirmuar nga ZVRPP
34	Petrit	Ahmet	Mernica	1471	11/11	Arë	2500	407.3	699	284,703	Konfirmuar nga ZVRPP
35	Ahmet	Ram	Mernica	1471	11/10	Arë	2001	464.4	699	324,616	Konfirmuar nga ZVRPP
36	Ismail	Aqif	Mernica	1471	11/22	Arë	3450	816.4	699	570,664	Konfirmuar nga ZVRPP
37	Aqif	Ram	Mernica	1471	11/19	Arë	950	317.0	699	221,583	Konfirmuar nga ZVRPP
38	Ali	Xhem	Kajusha	1471	11/7	Arë	1231	375.7	699	262,614	Konfirmuar nga ZVRPP
39	Shaban	Xhem	Kajusha	1471	11/6	Arë	3540	1274.7	699	891,015	Konfirmuar nga ZVRPP
40	Ramadan	Muharrem	Cimili	1471	40/8	Arë	13649	5057.3	699	3,535,053	Barre hipotekore
41	Bajram	Shaban	Cimili	1471	40/14	Arë	4543	1757.0	699	1,228,143	Konfirmuar nga ZVRPP
42	Pellumb	Muhare	Prenika	1471	48/116	Arë	5200	190.0	699	132,810	Konfirmuar nga ZVRPP
43	Vllaznim	Shefqet	Berisha	1471	48/37	Arë	1898	1492.0	699	1,042,908	Barre hipotekore
44	Asllan	Sinan	Prenika	1471	43/1	Arë	2033	2626.4	699	1,835,854	Konfirmuar nga ZVRPP
45	Feride	Halim	Berisha	1471	43/41	Arë	3800	860.8	699	601,699	Konfirmuar nga ZVRPP
46	Ermin	Bejdullah	Morina	1941	91	Arë	4160	4561.1	427	1,947,590	Konfirmuar nga ZVRPP
47	Thoma	Jorgji	Tushe	1941	84/39	Arë	6160	4587.7	427	1,958,948	Konfirmuar nga ZVRPP
48	Rrapush	Pali	Lico	1941	83/27	Arë	9246	1023.2	427	436,906	Konfirmuar nga ZVRPP
49	Enver	Tajar	Vrenozi	1941	83/39	Arë	6160	40.3	427	248248	Konfirmuar nga ZVRPP
50	Aleksander	Koli	Gjeci	1941	83/31	Arë	1100	17.0	427	7,259	Konfirmuar nga ZVRPP
51	Agron		Naci+BP.	3015	4/3	Arë	14273	1302.6	869	1,131,959	Konfirmuar nga ZVRPP
52	Qerim		Trakalaci	3015	5/3	Arë	14100	6877.6	869	5,976,634	Konfirmuar nga ZVRPP
53	Todi	Spiro	Prevazi	3015	57/11	Arë	5294	1745.0	869	1,516,405	Konfirmuar nga ZVRPP
54	Harilla	Vasil	Naci	3015	57/12	Arë	14000	6595.0	869	5,731,055	Konfirmuar nga ZVRPP
55	Aleksander	Llambro	Sheqit+BP.	3015	57/13	Arë	2000	3347.7	869	2,909,151	Konfirmuar nga ZVRPP
56	Anesti	Kostandin	Sheqit	3015	57/14	Arë	2000	826.4	869	718,142	Konfirmuar nga ZVRPP



57	Halit	Zeq	Vehapi	3015	57/16	Arë	28000	10688.4	869	9,288,220	Konfirmuar nga ZVRPP
58	Agim	Rushit	Limaj	3015	57/20	Arë	4115	1288.5	869	1,119,707	Konfirmuar nga ZVRPP
59	Nikoll	Marash	Lilndrea	3436	30/3	Arë	31000	6307.6	299	1,885,972	Konfirmuar nga ZVRPP
60	Ndue		Nikolla	3436	30/4	Arë	16856	3677.0	299	1,099,423	Konfirmuar nga ZVRPP
61	Kol		Froku	3436	30/5	Arë	16856	3679.5	299	1,100,171	Konfirmuar nga ZVRPP
62	Mark		Voci	3436	30/6	Arë	13132	2531.5	299	756,919	Konfirmuar nga ZVRPP
63	Zef	Ndue	Pepa	3436	30/7	Arë	5200	1265.8	299	378,474	Konfirmuar nga ZVRPP
64	Genci	Koci	Nilo	3038	113/5	Arë	7000	1565.0	134	209,710	Barre hipotekore
65	Koci	Vasil	Nilo	3038	113/6	Arë	7000	1551	134	207834	Barre hipotekore
66	Koci	Vasil	Nilo	3038	113/7	Arë	7000	1523.3	134	204122.2	Barre hipotekore
67	Koci	Vasil	Nilo	3038	113/8	Arë	7000	1514.3	134	202916.2	Barre hipotekore
68	Koci	Vasil	Nilo	3038	113/9	Arë	3110	1097.4	134	147051.6	Barre hipotekore
69	Zef	Ndue	Pepa	3436	25/1	Arë	13700	13690.3	299	4,093,400	Konfirmuar nga ZVRPP
70	Skender	Jonuz	Malaj	3436	24/2	Arë	22000	395.9	299	118,374	Konfirmuar nga ZVRPP
71	Halil	Jonuz	Malaj	3436	24/1	Arë	10000	6149.6	299	1,838,730	Konfirmuar nga ZVRPP
72	Xhevair	Muharrem	Malaj	3436	15/2	Arë	2640	330.2	299	98,730	Konfirmuar nga ZVRPP
73	Stefan	Leksi	Ndini	3436	15/4	Arë	2640	1584.5	299	473,766	Konfirmuar nga ZVRPP
74	Jani	Sander	Mihali	3436	18/12	Arë	5940	5217.8	299	1,560,122	Konfirmuar nga ZVRPP
75	Marash	Prend	Kovacaj	3436	19/8	Arë	22120	2555.0	299	763,945	Konfirmuar nga ZVRPP
76	Medi	Scit	Mucka	3436	250/8	Arë	2640	7575.6	299	2,265,104	Konfirmuar nga ZVRPP
77	Paskal	Andon	Bello	3436	56/9	Arë	5210	1093.6	299	326,986	Konfirmuar nga ZVRPP
78	Agron	Shpetim	Zeqaj	3436	86/5	Arë	4212	2726.5	299	815,224	Konfirmuar nga ZVRPP
79	Ipa	Identifikuar		3436	14(1-11)	Arë		2495.6	299	746,484	Proces regjistrimi
Vlerat totale e shpronësimit								175058.5		90,346,779	

VENDIM**Nr. 588, datë 10.9.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 12, DATË 6.1.2011, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR QAFËTHANË -
LIN - POGRADEK, LOTI I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 12, datë 6.1.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,

sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 6 017 (gjashtë mijë e shtatëmbëdhjetë) m², tokë arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 1 590 293.1 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre pikë një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 652 500 (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet përkatësisht:

a) Vlëra 1 371 981.3 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë tre) nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”;

b) Vlëra 218 311.8 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë tetë) lekë nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura” (detyrimet e infrastrukturës).”.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të shtohet nënndarja sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE, QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "QAFË
THANË-LIN-POGRADE" LOTI I(SHTESAT)

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pasurisë			Vlera totale (lekë)	Shënime
							Arë				
							Sip.	Çmimi	Vlera		
1	Resul	Dalip	Avdillari	2457	113/1	2400	826	264.3	218311.8	218311.8	Konfirmim ZVRPP
		Shuma								218311.8	

VENDIM

Nr. 590, datë 10.9.2014

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS TE MINISTRIA E
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES, TË OBJEKTIT
“ISH-KOMBINATI I TEKSTILEVE”,
BERAT, ME NUMËR PASURIE 19/59, NË
ZONËN KADASTRALE 8501, DHE
SIPËRFAQE 8 117 M², DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 226,
DATË 23.4.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT
RRUGOR, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës te

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të objektit “Ish-Kombinati i Tekstileve”, Berat, me numër pasurie 19/59, në zonën kadastrale 8501, dhe sipërfaqe 8 117 (tetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) m².

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave në administrim të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, miratuar me vendimin nr. 226, datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave.

3. Vendimi nr. 1079, datë 10.12.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e objektit “Ish-Kombinati i Tekstileve”, Berat, me numër pasurie 19/95, në zonën kadastrale 8501, me sipërfaqe 8 117 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM**

Nr. 591, datë 10.9.2014

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN DHE
MONITORIMIN E INDIKATORËVE “TË
BËSH BIZNES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve “Të bësh biznes”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij plani veprimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**PLANI I VEPRIMIT
PËR PËRMIRËSIMIN E INDIKATORËVE “TË BËSH BIZNES”**

Rekomandimi	Masa e propozuar	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Rezultati i pritshëm	Kur reflektohet ndikimi	Komente/status
Të hapësh një biznes						
Lehtësimi i barrierave të biznesit për regjistrimin e subjekteve	Amendimi i ligjit nr. 9723 datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”	Shtator 2014	MZHETS në bashkëpunim me MF, MMSR	-Shkurtimi me 2 hapa, -Reduktimi i kostos me 85,120 lekë	DB 2016	Drafti i ligjit është në proces konsultimi me ministrinë
	Amendimi i ligjit “Për nxitjen e punësimit”	Shkurt 2015	MF dhe MMSR		DB 2016	Amendimi i neneve që detyrojnë subjektet të regjistrohen pranë ISHPSHSH dhe zyrave të punës, në varësi të marrëveshjeve që do të lidhen me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shpërndarjen e informacionit mbi fuqinë punëtore në formë elektronike. Ndryshimet në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, parashikojnë që deklarata e paraqitur në administratën tatimore lidhur me punonjësit e rinj të marrë në punë dhe lidhur me punonjësit e larguar nga puna, do të shërbejë si deklarament edhe për Inspektoratin Shtetëror të Punës.
	Amendimi i ligjit “Për inspektimin e punës”	Dhjetor 2015			DB 2017	
	Miratimi i draft-ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”	Dhjetor 2014	MF		DB 2016	Draft-ligji është miratuar me VKM nr. 333, datë 4.6.2014 dhe ka eliminuar kërkesën për të pasur vulë në faturat e TVSH
Zbatimi i ligjit për firmën elektronike	Investime IT për të garantuar regjistrim të plotë on-line	Prill 2015	MZHETS/QKR	Fillimi i biznesit vetëm në 1 hap, 1 ditë, 100 lekë	DB 2016	
Lejet e ndërtimit						
Nxjitja e transparencës sa i përket dokumentacionit dhe kërkesave të aplikimit për leje	Miratimi i projektligjit për “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”	Shtator 2014	MZHUT / AKPT	Rritja e transparencës dhe garantimi i respektimit të afateve ligjore	DB 2016	Parashikohet që procesi i aplikimit dhe botimi i dokumentacionit të aplikimit të kryhet përmes Regjistratit të Planifikimit të Territorit. Projektligji është miratuar në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi i tij nga Kuvendi.
Nxjitja e transparencës sa i përket kërkesave të Agjencisë Rregullatore	Miratimi i projektligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”	Shtator 2014	MZHUT / AKPT	Rritja e transparencës për qytetarët dhe NJQV-të në lidhje me dokumentacionin e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit	DB 2016	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në momentin që konstaton që ka mangësi në publikimin e deklaramenteve mbi planin dhe zhvillimet në territor njofton menjëherë me shkresë zyrtare autoritetet përkatëse të planifikimit dhe vë në dijeni menjëherë autoritetet e inspektimit.
Bërja e planeve	Botimi i planeve kombëtare dhe vendore në	Janar 2015	AKPT	Rritja e	DB 2016	Autoritetet vendore të planifikimit



urbane të aksesueshme <i>on-line</i>	portalin e AKPT-së			transparencës për qytetarët dhe zhvilluesit e territorit		kanë detyrimin ligjor për botim në regjistër të instrumenteve të planifikimit. Krahas kësaj, AKPT do të botojë në portalin e saj të gjitha planet e miratuara për akses më të gjerë nga publiku.
Dhënia e mundësisë zhvilluesve për të bërë ndryshime në projektin fillestar gjatë procesit të ndërtimit	Miratimi i projektligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”	Shtator 2014	MZHUT / AKPT	Reduktimi i procedurave dhe i kohës për zbatimin e lejes së zhvillimit.	DB 2016	Projektligji parashikon rishikimin e kushteve të lejes së zhvillimit në rast se gjatë kryerjes së punimeve hasen situata të paparashikuara ekonomike që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit fillestar.
Bëra e aplikimit për leje ndërtimi e aksesueshme <i>on-line</i> në <i>web-in</i> e Bashkisë së Tiranës	Miratimi i projektligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.	Shtator 2014	MZHUT / AKPT / NJQV	Nxit transparencën.	DB 2016	Projektligji parashikon mundësinë e aplikimit <i>on-line</i> dhe aksesueshmërinë e aplikimeve përmes Regjistrat të Planifikimit të Territorit për të gjitha bashkitë dhe komunat e vendit. Realizimi konkret i rekomandimit do të varet nga mundësitë financiare për krijimin e platformës së aplikimit.
Krijimi i një procesi të përsheptuar inspektimi për disa lloje ndërtimesh.	Miratimi i projektligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.	Shtator 2014	MZHUT / AKPT	Reduktimi i kohës, lehtësimi i procedurave, nxitja e transparencës në fazën e inspektimit	DB 2016	Projektligji i propozuar nuk parashikon një procedurë të përsheptuar për ndërtime me rrezikshmëri të ulët dhe, rrjedhimisht, as procese të ndryshme inspektimi në varësi të llojeve të ndërtimit, por parashikon miratimin në heshtje për lejen e përdorimit të objektit në rast se nuk është marrë vendim brenda 15 ditëve nga afati përkatës dhe subjekti ka plotësuar pa shkelje të gjitha aktet e kontrollit.
Vlerësimi i mundësive për përdorimin e teknologjive të reja për të zgjeruar procesin e automatizimit	Miratimi i projektligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.	Shtator 2014	MZHUT / AKPT / NJQV	Thjeshtësimi i procedurave të aplikimit për leje zhvillimi, reduktimi i kohës, mija e transparencës	DB 2016	
Marja e energjisë						
	Pranim i propozimit për lidhjen e re në rrjetin e CEZ shpërndarje	3-mujori 4/ 2014	OPSHEE/ERE	Libërlizim dhe ndryshim tarifash	DB 2016	Masat e parashikuara në këtë indikator përfshihen në parashikimet e projektligjit “Për energjinë elektrike” iniciuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë
	Aplikim për lidhje të re	3-mujori i 4-t / 2014	OPSHEE/ERE		DB 2016	
	Dokumentet që duhen për lidhje të re sipas ERE	3-mujori i 4-t / 2014	ERE/MEI	Lista e dokumenteve për lidhje të re	DB 2016	
	Kontrate furnizimi me energji elektrike për klientët jofamiljarë	3-mujori i 2-të 2015	ERE/MEI/OPSHEE	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
	Dokumentacioni që nevojitet për kërkesat/ankesat e klientit	3-mujori i 2-të 2015	ERE/MEI/OPSHEE	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
	Detyrimet kontraktuale të shitjes së energjisë	3-mujori i 2-të 2015	ERE/MEI/OPSHEE	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
	Marrëveshje e lidhjes së re	3-mujori i 2-të 2015	ERE/MEI/OPSHEE	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
	Rregullorja për lidhjet e reja	3-mujori i 2-të 2015	ERE/MEI/OPSHEE	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
	Kontrolli inxhinierik për sigurinë teknike të lidhjeve elektrike mbi 20kVA	3-mujori i 2-të 2015	IQT/MEI	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
	Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit	3-mujori i 2-të 2015	ERE/IQT/MEI	Thjeshtësimi i procedurave	DB 2016	
Regjistrimi i pronësisë						
Nxjitja e përdorimit të akteve/marrëveshjeve të standardizuara lidhur me shitjen apo transferimin e titujve të pronësisë	Nënshkrimi i një memorandumit midis ZQRPP-së dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve	3-mujori i 3-të 2014	MD, ZQRPP, DhKN	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në ZQRPP dhe shërbimeve noteriale	DB 2016	Ky memorandum synon nxitjen, përdorimin dhe publikimin <i>on-line</i> të akteve/marrëveshjeve të standardizuara lidhur me shitjen apo transferimin e titujve të pronësisë
Reduktimi i kohës së regjistrimit të aktit publik në Zyrrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Hartim i një rregulloreje për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore të pasurive të paluajtshme	3-mujori i 3-të 2014	ZQRPP, MD dhe MF	Shkurtimi me 1 hap	DB 2016	
	Trajnim personeli	2014				Është ngritur grupi i punës në ZQRPP për zhvillimin e trajnimeve

¹ Operatori përgjegjës për shpërndarjen e energjisë elektrike (OPSHEE)



Lidhjen e ZRPP me regjistrin e pronës dhe digjitalizimi i plotë i të dhënave përkatëse	Përfundimi i procesit të krijimit të regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme	3-mujori i 4-t 2015	ZQRPP Kontraktorë dhe Donatorë	Reduktim i kohës së procesit të regjistrimit, rritje e transparencës dhe garancisë së informacionit të ofruar nga ZRPP	DB 2017	ALBSRP është krijuar për 10 ZVRPP dhe mbeten edhe 25 zyra të tjera
	Regjistrimi fillestar sistematik	3-mujori i 4-t 2016			DB 2017	
Konsiderata për mundësitë e krijimit të sistemit elektronik mbarëkombëtar të regjistrin të tokës me një qasje të informacionit të integruar	Përfundimi i digjitalizimit të të dhënave të regjistrin të tokës dhe përditësimi i tyre	2018	ZQRPP			Është në proces
Pagesa e taksave						
Reduktimi i numrit të deklarimeve për TVSH, tatim fitimin korporativ dhe kontributet e sigurimeve shoqërore	Reduktimi i pagesave të kësteve paraprake të tatim fitimit korporativ nga çdo muaj në çdo tre muaj	Realizuar	MF ² DPT	Reduktim i numrit të deklarimit dhe pagesave për këstet paraprake të tatim fitimit	DB 2015	Nga monitorimi i përbashkët që është bërë koha e deklaruar në <i>Doing Business</i> për plotësimin e deklarave, nuk është i saktë dhe është i ekzagjeruar.
	Propozim për ndryshim në ligjin. nr. 9136 datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësorë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	E zbatuar pjesërisht/ 1.10.2014	MF ²	Reduktimi i tre formularëve të deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësorë dhe tatimit mbi të ardhurat personale në një të vetme. Listëpagesa do të shërbejë si deklaratë tatimore për të tre taksat.	DB 2016	Projektligji është miratuar në KM me VKM nr. 387, datë 18.06.2014 dhe pritet miratimi i tij nga parlamenti. Zbatimi i ndryshimeve në sistemin informatik tatimor fillon më 1.10.2014.
	Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"	Pritet miratimi në Kuvend	MF ²		DB 2016	Thjeshtimi i procedurave të komunikimit me tatimpaguesin si dhe ulja e kostove administrative për të. Vendosija komunikimit administratë –tatimpagues nëpërmjet mesazhit elektronik; Administrata tatimore lëshon letërkujtesë për tatimpaguesin për pagimin e detyrimeve
	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar	Pritet miratimi në Kuvend	MF ²		DB2016	Deklarimi i taksave kombëtare dhe tarifave në mënyrë elektronike duke unifikuar deklaratën dhe datën e deklarimit.
	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998" Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar	Pritet miratimi në Kuvend	MF ²		DB2016	Ndryshon mënyra e llogaritjes së kësteve të tatimit, duke u bazuar në fitimin e një viti më parë e jo në atë të dy viteve më parë; Lëshohet një njoftim i vetëm vlerësimi për pagesën e kësteve të tatimit dhe jo dy njoftime vlerësime
Fuqizimi i funksionalitetit të sistemit të <i>e-payment</i> dhe komunikimi midis QKR dhe DPT	Propozim për shkurtim të numrit të llogarive të pagimit të tatimeve nga 1182 në 17 llogari. Përditësim të marrëveshjes ekzistuese të QKR me DPT gati në rang kombëtar.	E zbatuar pjesërisht/ 1.10.2014	MF ² DPT Shoqata e Bankave të Shqipërisë MZHETS, QKR, DPT	Shkurtim i kohës së pagesës së detyrimeve tatimore; Eliminimi i vështirësive të vërejtura gjatë këtyre viteve në përditësimin e të dhënave të tatimpaguesve	DB 2016	Jemi në komunikim me të dy aktorët për implementimin nëpërmjet sistemit të ri informatik të një mënyre pagese më eficiente për tatimpaguesit. Kjo marrëveshje do të implementohet menjëherë në sistemin e ri informatik tatimor që do të shkojë live me datë 1.10.2014
	Takime informuese dhe kualifikuese me biznesin për <i>e-payment</i>	Tremujori i 4-t 2014	MF/DPT	Rritja e informacionit tek biznesi për sistemin e ri		
Tregtia përmes kufijve						



Vlerësimi i mundësive për krijimin e sportelit të vetëm në doganë	Krijimi i një Task Force me përfaqësues të të gjitha institucioneve të përfshira në procesin e zhdoganimeve (import/eksport)	3 vjet	MP/DPD, MZHE/TS dhe të gjitha agjencitë që veprojnë në pikat e kalimit të kufirit	Përfutimet për biznesin: •Shkurtimi i kohës për praktikatat administrative; •Marja e informacionit në kohë reale mbi procedurat dhe aktet administrative; •Ulja e kostos së aplikimit; •Rritja e nivelit të transparencës dhe zbatueshmërisë ligjore; •Ulja e nivelit të korrupsionit; •Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional; •Lehtësimi i shkëmbimit të të dhënave në nivel ndërkombëtar duke rritur kështu nivelin e sigurisë etj.	Kërkesat për dokumente nga administrata doganore Për importimin e mallrave: -Deklaratë doganore; -Fatura; -Dokument transporti; - Listë paketimi. Për eksportimin e mallrave: -Deklaratë doganore; -Fatura; -Dokument transporti; Vështirësitë për realizimin: -Rezistenca ndaj ndryshimit; -Njohuritë informatike; -Perceptimi si punë e tepërt; -Technology-Hardware, software. Kostoja 500.000 euro
	Krijimi i një Task Force të brendshme qendrore për çdo institucion				
	Krijimi i një tavoline pune për çdo institucion në të cilën të analizohen informacionet që përmbajnë licencat/certifikatat/lejet/autorizimet, modalitetet procedurale për tu ndjekur në shkëmbimin e të dhënave, ekzaminim e problematikave të ndryshme				
	Përcaktimi i kategorive merceologjike Kodifikimet e licencave/certifikatave/lejeve/autorizimeve				
	Identifikimi i njësuar i licencave/certifikatave/lejeve/autorizimeve				
	Projektimi IT të një platforme <i>web</i> , të ndarë sipas enteve të përfshira, ku të bëhet kërkesa dhe të verifikohet statusi i praktikës, i aksesueshëm edhe nga operatorët ekonomikë. Implikimi i operatorëve ekonomikë si në nivel qendror ashtu edhe lokal				
	Caktimi i një apo dy zyrave pilot për testim, të preferueshme ato me pak volum pune				
	Testimi për disa muaj i procedurave me qëllim edhe të korrektimeve. Parashikimi i një pike kontakti në nivel lokal për asistencë				
Zbatimi i kontratave					
Rrëfyes për proceset gjyqësore për të identifikuar burimet e vonesës; me fokus të veçantë zbatimin e vendimeve gjyqësore	Ushtimi i inspektimeve në gjykata me objekt evidentimin e rasteve të zvarritjeve gjyqësore (çështje civile – ekzekutim i kontratave)	2014 - 2015	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë	Marja e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve për zvarritje të pajustificuar të gjykimit	Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në mbështetje të të cilit do të bëhet shkëmbimi i informacionit lidhur me këto raste.
	Ushtimi i inspektimeve pranë përmbarduesve gjyqësorë shtetërorë dhe privatë për të evidentuar rastet e vonesave në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore	2014 - 2015	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë	Marja e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve për zvarritje të pajustificuar të gjykimit	Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në mbështetje të të cilit do të bëhet shkëmbimi i informacionit lidhur me këto raste.
	Ushtimi i inspektimeve pranë përmbarduesve gjyqësorë shtetërorë dhe privatë për të evidentuar rastet e vonesave në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore	2014 – 2015	Ministria e Drejtësisë	Marja e masave disiplinore ndaj përmbarduesve gjyqësorë privatë që rezultojnë me shkelje	Ministria e Drejtësisë do të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe me Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Privatë për evidentimin e rasteve konkrete.
Përshpejtimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore	Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, për shkurtimin e procedurave gjyqësore	4-mujorin e tretë 2014	Ministria e Drejtësisë	Hartimi i ndryshimeve pritet të sjellë shkurtimin e afatit për zbatimin e vendimeve	DB 2016 Në fazën e hartimit mund të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së çështjes së përshpejtimin të zbatimit të vendimeve gjyqësore.
Mbledhja e të dhënave statistikore mbi veprimtarinë e gjykatave	Përcjellje periodike e të dhënave statistikore nga gjykatat mbi ngarkesën dhe afatet e gjykimit të çështjeve	2014 – 2015	Ministria e Drejtësisë & gjykatat	Hartimi i politikave sektoriale për përmirësimin e veprimtarisë së gjykatave	Gjykatat përcjellin pranë Ministrisë së Drejtësisë çdo 3 muaj të dhëna statistikore mbi performancën e tyre
Përmirësimi i sistemit të menaxhimit elektronik	Ndjekja e implementimit të sistemit ICMIS nga të gjitha gjykatat duke përfshirë edhe instalimin e këtij sistemi në gjykatat administrative	2014	Ministria e Drejtësisë & gjykatat	Digitalizimi i plotë i procesit gjyqësor	DB 2015
	Zgjerimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve ICMIS në të gjitha gjykatat, kontrolli mbi funksionimin e caktimit të mekanizmit të hedhjes së shortit.	2014-2015	Ministria e Drejtësisë & gjykatat	Digitalizimi i plotë i procesit gjyqësor	Sistemi ICMIS ka të integruar modulën e shortit elektronik i cili bën një shpërndarje rastësore dhe në sasi të barabartë midis gjyqtarëve të një seksioni gjykatë. Raportet që nxjerr sistemi për shpërndarjen e çështjeve, mund të vlerësohen në kohë reale nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë që merren me organizimin dhe administrimin e sistemit gjyqësor, në lidhje me transparencën, paanshmërinë, dhe volumet e shpërndarjes së çështjeve.
	Trajnime shtesë sidomos për Gjyqtarët në mënyrë që të zbatohet sistemi ICMIS plotësisht;	2014-2015	Ministria e Drejtësisë & gjykatat	Përmirësimi i aftësisë tek	



				gjyqtarët apo personeli administrativ në përdorimin e sistemit ICMIS		
	Investime në drejtim të infrastrukturës elektronike për gjykatat administrative në funksion të sistemit ICMIS	2014-2015	Ministria e Drejtësisë & gjykatat & ZABGJ	Digitalizimi i plotë i procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative përmirëson në lidhje me transparencën, paanshmërinë dhe volumet e shpërndarjes së çështjeve.		
Ofrimi i trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe personelin e gjykatave.	Përfshirja në kurrikulat e Shkollës së Magjistraturës të programeve të trajnimit	2014-2015	Shkolla e Magjistraturës	Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të gjykatave		Shkolla e Magjistraturës organizon aktivitetet trajnuese vazhduese për stafin e gjykatave.
Zgjidhja e paafëtisë së paguese						
Zhvillimi dhe rregullimi i procedurave të rishikimit të borxhit, forcimi i rolit të Agjencisë dhe rritja e kualifikimeve për administratorët e falimentimit.	Projekti ligji i ri “Për falimentimin” dhe aktet e tjera në zbatim të tij	Tetor-nëntor 2014	MD & AMF	-Shkurtimi i kohëzgjatjes së procedurave nëpërmjet afateve të reja ligjore -Rritje e shumës së detyrimit që do të përfitojnë kreditorët -Kosto me të ulta për shpenzimet e procedurës	DB 2016	Drafti do të jetë gati për miratim në shtator 2014
	Manualet për procedurat e likuidimit, riorganizimit, rishikimit të borxhit për individët	Tetor-nëntor 2014	MD & AMF		DB 2016	Manualet do të jenë gati në dhjetor 2014
	Organizimi i trajnimeve	Vazhdimisht	AMF	Trajnime dhe ndërgjegjësimi i palëve në proces.		Do të zhvillohen trajnime gjatë 2014 dhe viteve në vazhdim për administratorët e falimentimit, gjyqtarët dhe palët e tjera të interesuara.
	Organizimi i seminareve, tryezave të rumbullakëta, konferencave	Vazhdimisht	AMF	Ndërgjegjësimi i grupeve të interesit		

VENDIM**Nr. 592, datë 10.9.2014**

**PËR KRIJIMIN E FONDIT NË
MBËSHTETJE TË GRAVE
SIPËRMARRËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronjat “a”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, 7 e 8, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse, me vlerë të përgjithshme 26 500 000 (njëzet e gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë, për një periudhë zbatimi për 4 (katër) vjet.

Fondi i krijuar fillon të zbatohet në vitin 2014 me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

- Për vitin 2014, vlera e fondit të jetë 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.
- Për vitin 2015, vlera e fondit të jetë 5 000 000 (pesë milionë) lekë.
- Për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
- Për 2017, vlera e fondit të jetë 9 000 000 (nëntë milionë) lekë.

2. Fondi në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse, përveç buxhetit të shtetit të parashikuar si më sipër, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

3. Fondi në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse ka për qëllim subvencionimin e normës së interesit të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat drejtohen nga gratë si pronare apo administratore.

4. Kjo skemë konsiston në pagesën e interesave për kreditë e marra nga gratë dhe që do



të përdoren për investime në biznes. Ndiurma financiare do të mbulojë 50 % të normës së interesit, për 4 (katër) vite radhazi, dhe jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për një kredi, për ndërmarrjet që do të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në:

- a) sektorët prodhues dhe të shërbimit;
- b) sektorin e industrisë së lehtë, kryesisht në industrinë e përpunimit aktiv (fason);
- c) sektorin e turizmit;
- ç) fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;
- d) procesin e agropërpunimit;
- dh) fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.

5. Përfitimi i këtyre ndërmarrjeve nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga ky fond.

6. Gëzojnë të drejtën për të përfitur nga kjo skemë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të drejtuara nga gratë, të cilat janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit e zhvillojnë veprimtari në fushat e përcaktuara sipas pikës 4, të këtij vendimi, dhe që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Të jenë ndërmarrje, të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar.

b) Të kryejnë aktivitet tregtar për jo më pak se 12 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

c) Të kenë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit.

ç) Në planin e tyre të biznesit të parashikohet krijimi minimalisht i 1 (një) deri në 3 (tre) vendeve të reja të punës brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të fondit.

d) Të prodhojnë produkte ose të ofrojnë shërbime, që tregtohen apo që mund të tregtohen në nivel ndërkombëtar dhe që gjatë procesit i japin një vlerë të shtuar, të konsiderueshme, produktit përfundimtar.

dh) Të argumentojnë se aktivitetet që propozohen për mbështetje nga fondi janë të rëndësishme për zhvillimin e biznesit të tyre, nëpërmjet:

i) një vlerësimi mbi përfitimet e biznesit nga përmirësimi, në bazë të të cilit do të zhvillohen aktivitetet e propozuara;

ii) një plani biznesi ose një projekt duke argumentuar sa më sipër, i cili do të integrohet

dhe do të materializohet më tej nga aktivitetet e propozuara.

e) Të garantojnë për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara.

7. Në projektet që aplikohen duhet të identifikohen dhe të përshkruhen detyrimisht:

- a) qëllimi i projektit;
- b) termat e referencës për të gjitha aktivitetet që duhen nënkontraktuar;
- c) mënyra e menaxhimit të projektit, sistemit të monitorimit dhe vlerësimit;
- ç) në mënyrë të hollësishme veprimtaritë që do të kryejnë;

d) indikatorët e verifikueshëm;

dh) buxheti i detajuar, duke përfshirë burimet financiare dhe/ose të ardhurat;

e) rezultatet e pritshme.

8. Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, përfitojnë nga kjo skemë vetëm një herë.

9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e fondit që do të përdoret për subvencionin e interesave të kredive dhe për të lidhur marrëveshje me institucionet e mikrokredisë, si:

a) institucionet financiare jobankare;

b) dhe/ose shoqëritë e kursim-kreditit me qëllim disbursimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse.

10. Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse, e cila miratohet me urdhër të ministri përgjegjës për ekonominë.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, parashikohen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

12. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 593, datë 10.9.2014****PËR KRIJIMIN E FONDIT NË
MBËSHTETJE TË SIPËRMARRJEVE
TË REJA “START-UP”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronjat “a”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, 7, pika 2, dhe 8, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “*Start-up*”, për një periudhë zbatimi 4 (katër) vjet, me vlerë të përgjithshme 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë. Fondi i krijuar të fillojë në vitin 2014 dhe të zbatohet në këtë shtrirje kohore me vlerat e mëposhtme:

a) Për vitin 2014, me vlerë fondi gjithsej 2 000 000 (dy milionë) lekë.

b) Për vitin 2015, me vlerë fondi gjithsej 4 000 000 (katër milionë) lekë.

c) Për vitin 2016, me vlerë fondi gjithsej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

ç) Për vitin 2017, me vlerë fondi gjithsej 9 000 000 (nëntë milionë) lekë.

2. Sipërmarrje e re ose “*Start-up*” do të konsiderohet një kompani e sapokrijuar dhe në kërkim të tregjeve.

3. Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja, i krijuar në zbatim të këtij vendimi, do të financohet nga buxheti i shtetit dhe mund të ketë si burime financimi edhe fonde nga donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

Përfitimi nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucionet financiare ndërkombëtare, për këto sipërmarrje, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga ky fond.

4. Fondi ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare në mbështetje të sipërmarrjeve të reja, ndërmarrje mikro dhe të vogla, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në:

- a) sektorët prodhues dhe të shërbimit;
- b) sektorin e industrisë së lehtë;
- c) sektorin e turizmit;
- ç) fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;
- d) procesin e agropërpunimit;
- dh) fushën e disenjimit, modelimit, artizanatit.

Gëzojnë të drejtën e përfitimit nga ky fond ato sipërmarrje të reja, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë në sektorët e sipërpërmendur dhe janë të regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për një periudhë nga 1 (një) deri në 2 (dy) vjet.

5. Fondi mbulon 70% të kostove të pranuar dhe të miratuara nga komisioni vlerësues, në varësi të projektit konkurrues, por jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë.

6. Në kostot e pranuar, sipas pikës 5, të këtij vendimi, përfshihen kostot për:

- a) investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/shërbimit;
- b) marketing të produktit dhe promovim;
- c) kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive sipërmarrëse;
- ç) krijim faqeje interneti e publikime materialesh promovuese;
- d) pjesëmarrje në panair ose ekspozitë brenda apo jashtë shtetit, si vizitor apo ekspozues.

7. Sipërmarrjet e reja, për të përfituar nga fondi i përmendur në pikën 1, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të jenë ndërmarrje të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar.

b) Të kenë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit.

c) Të kenë një plan biznesi ose një projekt dhe të jenë të afta për zbatimin e duhur dhe në kohë të aktiviteteve të propozuara.

ç) Të krijojnë minimalisht 1-3 vende të reja pune brenda 12 muajve nga momenti i përfitimit të fondit.

d) Të jenë në gjendje të financojnë 50% të të gjitha kostove të projektit në fazën e aplikimit.



8. Pagesa e fondit të përfutur të bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në fund të përfundimit të projektit, kundrejt faturës/faturave e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera. Fondi i përfutur nuk mund të jepet më tepër se një herë për të njëjtën sipërmarrje.

9. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është përgjegjëse për menaxhimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja dhe ngritjen e Komisionit Vlerësues sipas procedurave dhe kritereve që përcaktohen në rregulloren e funksionimit të këtij fondi, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

11. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 595, datë 10.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 938, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KLUBIT SPORTIV “DINAMO” NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13,14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 938, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, zëvendësohet me “Ministria e Arsimit dhe Sportit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 596, datë 10.9.2014

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR DISA INSTITUCIONE, PËR FESTIMET E 70-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në kuadër të festimeve të 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendit, të shtohet fondi prej 94 000 000 (nëntëdhjetë e katër milionë) lekësh, i cili të ndahet për disa institucione, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 7 000 000 (shtatë milionë) lekësh, për kryerjen e punimeve restauruese në objektin 0774, vendkomanda taktike e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, pranë Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nr. 8010 dhe për mbështetjen e aktiviteteve të shoqatave të veteranëve.



b) Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh, për organizimin e koncertit të madh përmbyllës dhe të fushatës publicitare, me rastin e 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendit.

c) Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për:

i) organizimin e kampionatit sportiv mes shkollave “Kupa e 70-Vjetorit të Çlirimit”;

ii) organizimin e ekspozitës kombëtare mes shkollave 9-vjeçare dhe të mesme me imazhin e lirisë;

iii) konferencën shkencore për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

ç) Ministrisë së Kulturës, në programin “Arti dhe kultura”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekësh, për:

i) organizimin e ekspozitës “Albanian artists after the fall”, në hollin e Kryeministrit;

ii) Festivalin e Dritave;

iii) ndërhyrjen restauruese në 20 objekte përkujtimore të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare;

iv) ekspozitën në “Bunkerin antibërthamor të Linzës” (Objekti 0774, vendkomanda taktike e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, pranë Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nr. 8010).

d) Prefekturës Tiranë, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për kryerjen e punimeve restauruese në Varrezat e Dëshmorëve, Tiranë, në përgatitje të ceremonisë zyrtare të nderimit.

dh) Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për organizimin e pritjes zyrtare në Pallatin e Kongreseve, me rastin e 70-Vjetorit të Çlirimit të Vendit.

e) Kryeministrit, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, zëri “Shpenzime korrente”, fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për organizimin e aktiviteteve me rastin e

70-Vjetorit të Çlirimit të Vendit.

2. Efektet financiare të këtij vendimi prej 94 000 000 (nëntëdhjetë e katër milionë) lekësh përballohen nga fondi i kontingjencës, miratuar në buxhetin e vitit 2014.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Prefektura Tiranë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 597, datë 10.9.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014, NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHITESË PUNIMESH NË ZBATIM TË PROJEKTEVE “PËR RIKONSTRUKSIONIN E PALLATIT TË KONGRESEVE” DHE “PËR REALIZIMIN E QENDRËS MEDIATIKE NË PALLATIN E KONGRESEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2014 të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Kulturës t'i shtohen fondi prej 6 303 004 (gjashtë milionë e treqind e tre mijë e katër) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për shitesë punimesh në zbatim të projektit “Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve”, dhe



fondi prej 10 439 196 (dhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për projektin “Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve”.

b) Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare t'i pakësohet fondi prej 16 742 200 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dyzet e dy mijë e dyqind) lekësh, për rishpërndarjen e tij në buxhetin e Ministrisë së Kulturës.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Kulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 598, datë 10.9.2014

PËR SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE, NË KUADËR TË ORGANIZIMIT TË PUNËVE NË VIJIM TË ARDHJES SË PAPA FRANÇESKUT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t'i shtohet fondi prej 29 400 000 (njëzet e nëntë milionë e katërqind mijë) lekësh, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) 8 748 128 (tetë milionë e shtatëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të shtesës së punimeve në zbatim të projektit “Për ndërhyrje rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””;

b) 10 578 262 (dhjetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, për mbulimin e shpenzimeve për shtesë fondi në zbatim të projektit “Për realizimin e dekorit të qytetit të Tiranës në kuadër të vizitës së Papa Françeskut në Shqipëri”, si dhe aspektet organizative e protokollare të ceremonialit të vizitës së Papa Françeskut;

c) 1 673 610 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve “Për realizimin e altarit të meshës që do të mbajë Papa Françesku”;

ç) 8 400 000 lekë (tetë milionë e katërqind mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve që do të kryhen për realizimin ekspozitës në Muzeun Historik Kombëtar, në kuadër të ardhjes në Shqipëri të Papa Françeskut.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2014.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 599, datë 10.9.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1139, DATË 24.11.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË AUTOMJETEVE DHE TË SHOFERËVE NË DISPOZICION TË MINISTRIVE DHE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 1139, datë 24.11.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Numri i automjeteve të Kuvendit të përmendur në pikën 1, bëhet, në total, 16.

2. Emërtesa “Avokati i prokurimeve” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 600, datë 10.9.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 848, DATË 6.12.2011, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”,
TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË
SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË
SHOQËRIVE “TELEMENIA ALB”,
SHA, “F.K. GENERATORS
EQUIPMENT”, LTD, E “MELTA
INTER INDUSTRIES”, L.T.D., PËR
NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
MBI LUMIN CURRAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, të ligjit nr. 125/2013, “Për

koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 848, datë 6.12.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në kontratën e koncesionit, bashkëlidhur vendimit, bëhet ndryshimi, sipas tekstit të kontratës shtesë të koncesionit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në titullin e vendimit dhe kudo në përmbajtjen e tij, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
NR. 422 Rep.
NR. 235 Kol.



KONTRATË SHITESË KONCESIONI

PËR
NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM-
OPERIM-TRANSFERIM), PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE MBI LUMIN
CURRAJ, RRETHI TROPOJË”

Në Tiranë, më datë 6, muaji Gusht, viti 2014 (dymijë e katërbëdhjetë), para meje noter
Eva Blushi, anëtar i dhomës së Noterisë Gusht me adresë Rr. Bogdan, u
paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në emërinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar nga z. Ilir
Bejtja, i datëlindjes 17.01.1966, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të
cilit u sigurova nga ID G60117004R,

DHE

Shoqëria “Telemenja Curraj” sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me
NIPT L26529002R dhe datë 29/03/2012, e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z
Ardjan Kimça, i biri i Ejll i datëlindjes 13.07.1971, banues në Shkoder, Lagja “3 Heronjte” rruga
“Çerçiz Topulli”, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u
sigurova nga ID NR 027632974

Palët të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë Koncesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit të formës
“BOT”, të nënshkruar nga palët: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimi i
Shoqërive “Telemenja Alb” sh.a., “F.K. Generators Equipment” l.t.d. dhe “Melta Inter Industries”
l.t.d., me date 5.12.2011 me Nr. 9299 Rep. dhe Nr. 3920 Kol. “Për ndërtimin e hidrocentraleve mbi
lumin Curraj, Rrethi Tropojë”, miratuar me VKM nr. 848 date 6.12.2011

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Në kontratën e Koncesionit të formës “BOT”, “Për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin
Curraj, Rrethi Tropojë”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
dhe Bashkimit të Shoqërive “Telemenja Alb” sh.a., “F.K. Generators Equipment” l.t.d. dhe
“Melta Inter Industries” l.t.d., miratuar me VKM nr. 848 date 6.12.2011, ku në pikën 14.1.3 të
Kreut III cilësohet se: “ Afatet mund të ndryshohen në marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues
dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së
rregullt procedurale të marrjes së tyre.



- Vonesat e krijuara nga Ministria e Mjedisit për autorizimin e heqjes e parcelave te tokës nga fondi i pyjeve. Aplikimi pranë Ministrisë së mjedisit është kryer me ane te shkresave me nr. 4304 date 31.5.2013 dhe nr. 4304/1 date 3.6.2013, dhe Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Ministrisë së Mjedisit përshpejtimin e procedurave per heqjen nga fondi pyjor i tokës ne te cilat parashikohet ndërtimi i hidrocentraleve, ndërkohë që ky autorizim akoma nuk është dhënë.
- Procesin e financimit te këtij projektit, per te cilën negociatat me bankat financuese janë me te komplikuar si rezultat te vështirësive dhe rritjes se nivelit te rriskut se projektit dhe per kete arsye MEI i është drejtuar me shkresën nr. 13/24 Prot. date 9.6.2014 Bankës Evropiane per Rindërtim dhe Zhvillim me ane te se cilës është kërkuar bashkëpunim per mbështetjen e projekteve koncesionare ne ndërtimin e HEC-ve

Në kontratën e koncesionit të formës BOT për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Curraj, Rrethi Tropoje” të nënshkruar nga palët më datë 5.12.2011 me Nr. 9299 Rep. dhe Nr. 3920 Kol., dhe te miratuar me VKM nr. 848 date 6.12.2011 të bëhet nje ndryshim :

Neni 1

Në kreun III pika 14.1.2

zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

“Koncesionari merr përsipër te vere ne pune Hidrocentralin brenda 12 muajve nga data e marrjes se lejeve. Afati per pajisjen me lejet e nevojshme eshte jo me shume se 42 muaj nga data e hyrjes ne fuqi te Kontrates se Koncesionit. Afati i ndërtimit është parashikuar ne grafikun e punimeve te paraqitur ne aneksin K.

Neni 2

Kjo kontratë shtesë koncesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Kontrata Shtesë e koncesionit u hartua në 4 (kater) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë dhe unë noter i vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Përfaqësuar nga:

Z. Ilir BEJTJA

SHOQËRIA

“Telemenja Curraj” sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

Z. Ardjan Kimça

Water
Eve Blush
Blush

ARDJAN KIMÇA

**VENDIM****Nr. 602, datë 10.9.2014****PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 459, DATË 23.9.1999, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR
PËR KULTET”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i dytë, i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion qendror, person juridik, në varësi të Kryeministrit.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga Kryeministri. Gjatë emërimit të përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, Kryeministri dhe kryetari i komitetit marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjansisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin që struktura e komitetit të reflektojë, realisht, identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja "Kristalina"
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006

Çmimi 24 lekë